



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 30.03.2023

Nr: 37

Ora: 14:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 40, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 30.03.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 30.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: z. Mehmet Nelaj

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 17, datë 27.03.2023, të KZAZ-së nr. 90 të bashkisë Sarandë

BAZË LIGJORE: Nenet 21/c, 123/1, 126 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 9 dhe

10, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Z. Mehmet Nelaj ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 40 regj., datë 30.03.2023.

Në mbledhjen e datës 30.03.2023, ora 14:00, pas relatimit të z. Koli Bele, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 40 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 40, datë 30.03.2023 të paraqitur nga z. Mehmet Nelaj;
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 31.03.2023 ora 14:00;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Koli BELE - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar